



**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KANCELARI**

Nr. 3089/prot.

Tiranë, më 16 .09.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026 me lëndë: “Kërkesë për rishikimin e dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar”.

**Z. Maksim HAXHIA
KRYETAR I
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË**

TIRANË

I nderuar z. Haxhia,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 228 prot., datë 01.09.2026¹, përmes së cilës shprehet mosrënia dakord lidhur me zbatimin e disa dispozitave të Rregullores së Brendshme “Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO)” (në vijim Rregullorja), dhe në veçanti me kërkesën për rishikimin e nenit 76 të saj lidhur me mbajtjen dhe përdorimin e telefonave celularë në sallën e gjykimit, GJKKO-ja çmon të nevojshme të sqarojë dhe parashtrojë sa më poshtë vijon:

1. Fillimisht GJKKO-ja gjen me vend të theksojë se vlerëson rëndësinë thelbësore të rolit të avokatit në garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe e konsideron dialogun institucional me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë pjesë të rëndësishme të mirëfunksionimit të sistemit të drejtësisë. Avokatia është një komponent i domosdoshëm i administrimit të drejtësisë dhe ushtrimi i lirë, i pavarur dhe efektiv i funksionit të mbrojtjes përbën një garanci që GJKKO-ja ka detyrimin ta respektojë dhe ta sigurojë.
2. Sikurse është e njohur edhe nga përvoja profesionale e shumë anëtarëve të Dhomës së Avokatisë që ushtrojnë veprimtarinë pranë GJKKO-së, natyra e posaçme e juridiksionit të saj dhe karakteristikat e çështjeve që shqyrtohen kërkojnë, njëkohësisht, standarde të shtuara të sigurisë. Në sallat e gjykimit administrohen

¹ Protokolluar nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me nr. 3099 prot., datë 02.09.2026.

drejtpërdrejt prova në procedime që lidhen me korrupsionin e nivelit të lartë, krimin e organizuar, organizatat kriminale dhe terrorizmin; dëgjohen dëshmitarë të mbrojtur dhe bashkëpunëtorë të drejtësisë; paraqiten të pandehur ndaj të cilëve zbatohen masa të posaçme sigurie; si dhe zhvillohen gjykime që, për shkak të natyrës së tyre, janë shpesh objekt i një vëmendjeje të lartë publike dhe mediatike. Në të njëjtin kontekst, godina ku ushtron veprimtarinë GJKKO-ja është klasifikuar si objekt me rëndësi të veçantë dhe ruhet nga Garda e Republikës.²

3. Administrimi i drejtësisë nuk matet vetëm nga përmbajtja e vendimeve, por edhe nga kushtet institucionale në të cilat ato merren. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe publicitetin e gjykimit; megjithatë, vetë Konventa e pranon shprehimisht se ky publicitet nuk është absolut dhe se akses i publikut dhe i medias mund të kufizohet, tërësisht ose pjesërisht, kur këtë e kërkojnë rendi publik, siguria, mbrojtja e jetës private të palëve ose interesat e drejtësisë. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e ka konsoliduar këtë qasje: gjykimi publik mbetet rregull dhe kufizimi i tij përjashtimi, por ky përjashtim është plotësisht i ligjshëm kur parashikohet në një akt, ndjek një qëllim legjitim dhe respekton proporcionalitetin. Në të njëjtën frymë, Gjykata ka pranuar se shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në rregullimin e fotografimit, filmimit dhe transmetimit nga sallat e gjyqit, me qëllim mbrojtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së gjyqësorit, ruajtjen e dinjitetit të pjesëmarrësve dhe zhvillimin e rregullt të procesit. Po aq e rëndësishme është se standardet e Konventës nuk i njohin shtetit vetëm një të drejtë për të rregulluar këto çështje, por i ngarkojnë edhe një detyrim pozitiv për të garantuar sigurinë e gjyqtarëve, të personelit, të palëve, të dëshmitarëve dhe të publikut brenda ambienteve gjyqësore. Në këtë kuptim, siguria dhe publiciteti nuk janë vlera kundërshtuese, por dy komponentë që duhen harmonizuar; dhe rregullimi që kjo Gjykatë ka miratuar synon pikërisht këtë harmonizim, e jo kufizimin e ndonjë kategorie të caktuar subjektsh procedurale.³
4. Në këto kushte, është mëse e kuptueshme që siguria e sallës së gjykimit dhe solemniteti i procesit nuk përbëjnë çështje thjesht forme, protokolli apo formaliteti institucional, por ato janë kushte funksionale dhe të domosdoshme për administrimin e drejtësisë në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe të besueshme dhe shërbejnë për mbrojtjen e sigurisë dhe integritetit fizik të pjesëmarrësve në proces, të dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të konfidencialitetit të të dhënave sensitive, të integritetit të provave dhe, në tërësi, të vetë procesit gjyqësor. Siguria dhe e drejta e mbrojtjes nuk përjashtojnë njëra-tjetrin. Detyrimi institucional i GJKKO-së është t'i

² Shih VKM-së nr. 597, datë 13.10.2021, "Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me VKM nr. 507, datë 27.07.2022.

³ Shih *Axen kundër Gjermanisë*, nr. 8273/78, vendim i datës 08.12.1983; *Diennet kundër Francës*, nr. 18160/91, vendim i datës 26.09.1995; *Riepan kundër Austrisë*, nr. 35115/97, vendim i datës 14.11.2000 — mbi publicitetin e gjykimit si rregull dhe kufizimin e tij si përjashtim të justifikuar; *Leost kundër Francës*, vendim mbi pranueshmërinë — mbi hapësirën e vlerësimit të shteteve në rregullimin dhe ndalimin e fotografimit e të regjistrimit në sallat e gjyqit; *Yaroslav Belousov kundër Rusisë*, nr. 2653/13 dhe 60980/14, vendim i datës 04.10.2016 — mbi detyrimin pozitiv të shtetit për të garantuar sigurinë në sallën e gjykimit.

garantojë ato njëkohësisht, duke ruajtur ndërmjet tyre një ekuilibër të drejtë dhe proporcional.

5. Pikërisht në këtë kontekst duhet kuptuar dhe interpretuar edhe neni 76 i Rregullores. Normimi i parashikuar në të nuk është konceptuar si kufizim ndaj profesionit të avokatit dhe as si masë e drejtuar ndaj një subjekti procedural të caktuar, por si pjesë e një regjimi të përgjithshëm të sigurisë dhe solemnitetit të sallës së gjykimit. Rregullorja ka karakter organizativ dhe sigurie dhe nuk krijon rregulla të reja të procedurës penale, nuk zëvendëson apo kufizon legjislacionin procedural në fuqi dhe nuk cenon kompetencat që ligji i njej trupit gjykues.
6. GJKKO-ja e konsideron të rëndësishme fillimisht të theksojë faktin, i cili do të argumentohet më gjerësisht në vijim, se neni 76 i Rregullores, në asnjë rast nuk e cenon apo kufizon ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes. Kufizimi i mbajtjes dhe përdorimit të telefonit celular brenda sallës së gjykimit nuk e lë palën mbrojtëse pa mjetet e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tij procedural. Rregullorja parashikon mundësinë e përdorimit në sallë të kompjuterit portativ për mbajtjen dhe konsultimin e akteve, provave, dosjes elektronike dhe jurisprudencës, si dhe për mbajtjen e shënimeve, si dhe garanton mundësinë e komunikimit konfidencial ndërmjet avokatit dhe të mbrojturit. Në këtë mënyrë, kufizimi i mbajtjes dhe përdorimit të telefonit celular nuk mund të konsiderohet apriori kufizim i ushtrimit dhe mjeteve të palës mbrojtëse pa i provuar pasojat efektive të ndalimit të tij në sallën e gjyqit.
7. Për rrjedhojë, vlerësimi rregullues i nenit 76 i Rregullores nuk mund të reduktohet në pyetjen nëse avokati mban ose jo një telefon celular në sallën e gjykimit. Çështja që shtrohet është nëse kufizimi konkret ka bazë ligjore, ndjek një qëllim legjitim, është proporcional me këtë qëllim dhe, në tërësinë e rregullimit, i jep mbrojtësit mundësinë reale dhe efektive për të ushtruar funksionin e tij procedural. Sikurse do të argumentohet në vijim, GJKKO-ja çmon se rregullimi i parashikuar në nenin 76 të Rregullores i përmbush tërësisht këto kërkesa.
8. Mbi këtë bazë, në vijim të kësaj shkrese do të parashtrohen baza ligjore e këtij rregullimi, arsyet institucionale dhe të sigurisë që e kanë diktuar, standardet relevante kombëtare, ndërkombëtare dhe krahasuese, mënyra e zbatimit të tij, si dhe garancitë konkrete të parashikuara për ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, si një e drejtë kushtetuese e garantuar në kuadër të procesit të rregullt ligjor, në bazë të nenit 42 të Kushtetutës.

- **Specifika institucionale e GJKKO-së**

9. Çdo vlerësim i rregullimit të kontestuar duhet të nisë nga natyra e veçantë e kësaj gjykate. GJKKO-ja nuk është një gjykatë e zakonshme e shkallës së parë. Ajo organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 95/2016, *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar. Kompetenca e saj lëndore parësore, sipas nenit 8 të këtij ligji dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP), shtrihet mbi korrupsionin e nivelit të lartë, krimin e organizuar, organizatat kriminale, terrorizmin dhe akuzat penale ndaj

funksonarëve më të lartë të shtetit. Pikërisht natyra e këtij juridiksioni shoqërohet me rreziqe që për shkak të natyrës dhe përqendrimit të çështjeve në kompetencën e saj, paraqiten me intensitet të shtuar krahasuar me juridiksionin e zakonshëm: prani të pandehurish me rrezikshmëri të lartë, dëshmitarë të mbrojtur, bashkëpunëtorë të drejtësisë, si dhe një interes publik e mediatik jashtëzakonisht i lartë. Në këtë kontekst, Rregullorja e GJKKO-së nuk përfaqëson një zgjidhje të veçantë, por përkon me modelin që ndjekin sot institucionet kryesore ndërkombëtare të administrimit të sigurisë gjyqësore.

10. Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore e Shteteve të Bashkuara (National Center for State Courts – NCSC), në udhëzimin e saj “*Steps to Best Practices for Court Building Security*”, e trajton sigurinë e gjykatës si pjesë të vetë administrimit efektiv të drejtësisë dhe jo si ruajtje e thjeshtë fizike e objektit.⁴ Sipas këtij modeli, siguria ndërtohet si sistem i integruar që përfshin politikën e sigurisë, kontrollin e hyrjeve, ndarjen e ndërtesës në zona publike, zona me akses të kontrolluar dhe zona të kufizuara, si dhe administrimin e mediave dhe të pajisjeve elektronike përmes politikash të qarta, me qëllim mbrojtjen e sigurisë së pjesëmarrësve dhe të integritetit të procesit. Në këtë kuadër, administrimi i pajisjeve elektronike merr rëndësi edhe për parandalimin e regjistrimeve ose transmetimeve të paautorizuara që mund të cenojnë privatësinë, të ekspozojnë dëshmitarët ose të krijojnë rreziqe sigurie.

11. E njëjta qasje ndiqet edhe nga Shërbimi i Marshallëve të Shteteve të Bashkuara (United States Marshals Service – USMS), autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e gjyqtarëve federalë dhe të objekteve gjyqësore, i cili e ndërton mbrojtjen mbi analiza të vazhdueshme të kërcënimeve, vlerësime individuale të riskut dhe planifikim operacional, dhe jo mbi reagimin pasiv ndaj incidenteve tashmë të ndodhura.⁵ Kjo qasje parandaluese (*Protective Security*) është në përputhje me qasjen parandaluese të ndjekur nga Rregullorja e GJKKO-së: kontrolli i pajisjeve elektronike nuk synon të ndëshkojë një sjellje të kaluar, por të eliminojë burimin e rrezikut përpara se ai të materializohet.

• **Roli i Gardës së Republikës dhe kompetencat e saj në ambientet e GJKKO-së**

12. Mbrojtja e GJKKO-së realizohet edhe nga Garda e Republikës, veprimtaria e së cilës rregullohet me ligjin nr. 33/2021 “*Për Gardën e Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar. Misioni i saj, sipas nenit 2, është garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, ndërsa neni 7 i njeh asaj një sërë kompetencash që lidhen drejtpërdrejt me çështjen në shqyrtim:

- verifikimin e identitetit të personave para se të hyjnë në objektet në ruajtje (neni 7/1/dh);

⁴ National Center for State Courts (Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore), “*Steps to Best Practices for Court Building Security*” (“Hapat drejt praktikave më të mira për sigurinë e godinave gjyqësore”); <https://www.ncsc.org/resources-courts/best-practices-court-building-security>

⁵ United States Marshals Service (Shërbimi i Marshallëve të Shteteve të Bashkuara), “*Protecting the Judiciary*” (“Mbrojtja e pushtetit gjyqësor”); <https://www.usmarshals.gov/what-we-do/judicial-security/protecting-judiciary>

- kontrollin fizik të personelit dhe të personave të tjerë, si dhe të çdo bagazhi të tyre, para hyrjes, për praninë e armëve, sendeve ose lëndëve të tjera me rrezik (neni 7/1/f);
- kontrollin paraprak dhe të vazhdueshëm të objekteve në ruajtje dhe të pajisjeve (neni 7/1/g);
- marrjen e masave për bllokimin e valëve transmetuese për të gjitha pajisjet ose në mënyrë përzgjedhëse, kur e gjykon të domosdoshme (neni 7/1/i).

13. Kompetenca e fundit është veçanërisht domethënëse. Ligjvënësi ka pranuar shprehimisht se, në mjedise të mbrojtura, mund të bllokohet vetë funksionimi teknik i pajisjeve elektronike, kur kjo është e domosdoshme për sigurinë. Nëse ligji lejon një masë kaq intensive, atëherë një masë dukshëm më e lehtë, siç është mosmbajtja e pajisjes brenda një salle të caktuar, përbën një tregues të rëndësishëm se vetë ligjvënësi ka njohur legjitimitetin e ndërhyrjeve parandaluese mbi funksionalitetin e pajisjeve elektronike në objekte të sigurisë së veçantë.
14. Duhet të mbajmë parasysh faktin se godina e GJKKO-së është klasifikuar si *objekt me rëndësi të veçantë* dhe mbrohet nga Garda e Republikës, referuar VKM-së nr. 597, datë 13.10.2021, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me VKM-në nr. 507, datë 27.07.2022. Ky klasifikim nuk ka karakter simbolik, por përfaqëson vlerësimin institucional se veprimtaria që zhvillohet në këtë objekt paraqet interes të veçantë për sigurinë publike dhe administrimin e drejtësisë. Pikërisht për shkak të këtij statusi, Rregullorja e Gardës së Republikës, miratuar me VKM-në nr. 777, datë 15.12.2021, parashikon shprehimisht, në nenin 61, pika 9, se personeli i shërbimit “kërkon dorëzimin e telefonave celularë, laptop dhe çdo pajisje tjetër elektronike për ta vendosur në raftin për vizitorët”, pikërisht në momentin e kalimit nga zonat publike në ambientet e brendshme me akses të kontrolluar, të kufizuar ose të sigurisë së lartë.
15. Rrjedhimisht, rregulli i nenit 76 nuk përbën një zgjedhje organizative të shkëputur nga kuadri normativ i sigurisë, por është konkretizim i një regjimi sigurie që buron drejtpërdrejt nga statusi i posaçëm i objektit dhe nga aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Gardës. Gjykata, si institucion i ruajtur dhe i mbrojtur sipas akteve në fuqi, ka detyrimin ta harmonizojë rregulloren e saj të brendshme me këtë regjim normativ, dhe nuk mund ta trajtojë atë si fakultativ.
16. Së fundmi, neni 10, pika 3, e ligjit nr. 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e çdo personi fizik ose juridik për të mos penguar punonjësit e Gardës në kryerjen e detyrave të tyre. Rregullat e mbajtjes së pajisjeve, të dorëzimit të tyre përpara kalimit në zonat me akses të kufizuar dhe të kontrollit në hyrje janë pjesë e këtij kuadri dhe nuk përbëjnë krijim kompetencash të reja nga Gjykata.

• **Objekti i rregullimit të kontestuar dhe natyra juridike e tij**

17. Neni 76 i Rregullores parashikon se në sallën e gjykimit ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe i pajisjeve të tjera elektronike, përveç rasteve të

parashikuara në nenet 77 dhe 78 të saj. Ky rregullim nuk është dispozitë disiplinore dhe as masë e drejtuar ndaj një kategorie të caktuar subjektsh. Ky rregull është pjesë e një sistemi të integruar sigurie, objekti i të cilit, sipas nenit 1 të Rregullores, përfshin sigurinë, rendin, rregullat e sjelljes, kontrollin e aksesit dhe garantimin e zhvillimit normal e solemn të veprimtarisë gjyqësore.

18. Njëkohësisht, GJKKO-ja thekson se, sipas nenit 7, pikat 2 dhe 4, të Rregullores, masat e sigurisë kanë karakter administrativ dhe nuk cenojnë kompetencat procedurale të trupit gjykues; në rast mospërputhjeje ndërmjet një mase administrative sigurie dhe një vendimmarrjeje procedurale, prevalon vendimmarrja procedurale e trupit gjykues, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Rregullorja, pra, nuk zëvendëson dhe nuk kufizon legjislacionin procedural në fuqi.
19. Nga ana tjetër, në kushtet e zhvillimit teknologjik, telefoni celular nuk është vetëm mjet komunikimi. Ai është pajisje shumëfunktionale që ka njëkohësisht funksionin e aparatit fotografik, të kamerës filmike, të regjistruarit audio, të pajisjes së transmetimit të drejtpërdrejtë, të platformës së komunikimit të koduar, të mjetit të lokalizimit në kohë reale dhe të instrumentit të shpërndarjes së menjëhershme të informacionit në rrjetet sociale.
20. Rreziku nuk qëndron vetëm te përdorimi i dukshëm i pajisjes, por te vetë prania e saj në sallë. Kështu, telefoni mund të aktivizohet brenda pak sekondash, të regjistrojë pa sinjale të dukshme, të transmetojë me ekran të fikur, të fotografojë nga pozicione të fshehta, pa qenë e mundur ndërhyrja efektive e personelit të sigurisë.
21. Për këtë arsye, një ndalim i kufizuar vetëm të përdorimit aktiv do të do të paraqiste vështirësi serioze për zbatim ku as personeli i sigurisë, as trupi gjykues nuk kanë mundësi të verifikojnë vazhdimisht nëse një pajisje është e fikur, në modalitet të heshtur, në regjistrim apo në transmetim të drejtpërdrejtë, pa kërkuar një monitorim të pandërprerë që do të cenonte vetë zhvillimin normal të procesit.
22. Rregullorja ndjek këtu qasjen e parandalimit të riskut, sipas të cilit niveli më i lartë i kontrollit nuk arrihet me mbikëqyrjen e vazhdueshme të sjelljes së personit, por me largimin paraprak të vetë burimit të rrezikut nga mjedisi i mbrojtur. Në një proces penal, edhe një fotografi e vetme, një regjistrim prej pak sekondash ose një transmetim i shkurtër mund të prodhojë pasoja të pakthyeshme: zbulimin e identitetit të një dëshmitari të mbrojtur, ekspozimin e masave të sigurisë, publikimin e materialeve procedurale sensitive ose krijimin e presionit publik mbi një gjykim ende në zhvillim. **Parimi i proporcionalitetit nuk kërkon thjesht zgjedhjen e masës më pak kufizuese, por të masës më pak kufizuese ndër ato që janë vërtet të afta ta arrijnë qëllimin legjitim; një masë që e kufizon më pak të drejtën, por që nuk e parandalon efektivisht rrezikun, nuk është masë proporcionale, sepse nuk arrin të mbrojë dot asnjë nga të dyja interesat.**

- **Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë**

23. GJKKO-ja e çmon me rëndësi të veçantë të tërheqë vëmendjen tuaj mbi një standard tashmë të brendshëm dhe të konsoliduar të vetë juridiksionit më të lartë kushtetues të vendit gjatë dekadës së fundit.

24. Rregullorja për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, miratuar me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe ndryshuar me vendimin nr. 13, datë 31.10.2023, në nenin 34 të saj, i kushtuar rregullave të solemnitetit, parashikon:

- në pikën 2, shkronja "d", si detyrim të vetë gjyqtarit kushtetues, ***“mosmbajtja dhe përdorimi i telefonit celular gjatë seancës”***;
- në pikën 3, shkronja "e", si rregull solemniteti për të gjithë pjesëmarrësit, ***“mosmbajtja e telefonit celular gjatë zhvillimit të seancës plenare”***, duke shtuar se *“përfshihet, palët mund të mbajnë pajisje të tjera elektronike (tablet, laptop ose të ngjashme me to) për të siguruar mbajtjen e shënimeve gjatë seancës dhe në funksion të mbrojtjes në gjykim”*.

25. Pra, Gjykata Kushtetuese ndalon mbajtjen e telefonit celular, jo thjesht përdorimin e tij; e shtrin këtë ndalim edhe mbi vetë gjyqtarin; dhe lejon si përjashtim pikërisht pajisjet e tjera elektronike, konkretisht laptopin dhe tabletin, duke e lidhur shprehimisht këtë përjashtim me mbajtjen e shënimeve dhe me funksionin e mbrojtjes në gjykim. Kjo është pikërisht logjika e neneve 76 dhe 77 të Rregullores së kësaj Gjykate.

26. Vlen të theksohet gjithashtu se e njëjta rregullore, në nenin 6, pika 3, të saj, lejon praninë e medias në sallë për sa kohë nuk pengohet zhvillimi normal i seancës, por parashikon se regjistrimet radiofonike, televizive, audio ose video lejohen vetëm me pëlqimin e Gjykatës, ndërsa mesazhet ose komunikimet me zë gjatë seancës nuk lejohen. Po ashtu, neni 34, pika 5, i njeh kryesuesit të seancës kompetencën për të tërhequr vëmendjen, për të hequr të drejtën e fjalës, për të vendosur largimin nga sallja dhe për t’ia referuar sjelljen e avokatit organeve përkatëse.

27. Rrjedhimisht, rregullimi i kontestuar nga ana juaj nuk përbën një zgjidhje të izoluar apo të panjohur në rendin e brendshëm juridik shqiptar. **Përkundrazi, ai gjen një precedent të drejtpërdrejtë normativ në rregullat që vetë Gjykata Kushtetuese zbaton për zhvillimin e seancave të saj.**

- **Standardet ndërkombëtare dhe praktika krahasuese**

28. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE), në rregullat e saj zyrtare lidhur me sigurimin e aksesit dhe sjelljen gjatë seancave, parashikon se telefonat celularë duhet të jenë të fikur gjatë zhvillimit të seancës, ndërsa fotografimi, filmimi dhe regjistrimi i procedimeve janë të ndaluara, përveç kur ekziston autorizim i posaçëm i Gjykatës. Vetë GJDBE-ja shpjegon se këto masa synojnë të garantojnë zhvillimin normal të seancës, të shmangin ndërhyrjet në procedim dhe të ruajnë solemnitetin e procesit.⁶

⁶ Court of Justice of the European Union (Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian), “Security rules and rules of conduct” (“Rregullat e sigurisë dhe rregullat e sjelljes”): https://curia.europa.eu/jcms/jcms/P_127468/en; “Press Service – Media Guide” (“Shërbimi i Shtypit – Udhëzues për median”): https://curia.europa.eu/site/jcms/qual_6617/en/press-service-media-guide.

29. Ky standard ka rëndësi të veçantë, sepse GJDBE-ja, ashtu si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*), është kryesisht gjykatë ligji: nuk zhvillon administrim të drejtpërdrejtë të provave, nuk pyet dëshmitarë në mënyrën karakteristike të gjykatave të faktit dhe nuk përballlet me nivelin e rrezikut që paraqesin procedimet penale kundër krimit të organizuar apo korrupsionit të nivelit të lartë. E megjithatë, edhe në këto kushte, ajo e ka konsideruar të nevojshëm kufizimin e pajisjeve elektronike.
30. Përtej praktikës institucionale të GJDBE-së, i njëjti standard gjendet edhe në rregullat e vetë GJEDNJ-së për zhvillimin e seancave të saj publike, në praktikën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, si dhe në modele krahasuese të disa prej sistemeve gjyqësore evropiane dhe të drejtës anglo-saksone.
31. Vetë GJEDNJ-ja, në udhëzimin e saj për sigurinë dhe sjelljen gjatë seancave publike, kërkon që gazetarët të fikin laptopët, kamerat ose çdo pajisje tjetër elektronike gjatë zhvillimit të seancës; filmimi brenda sallës është i ndaluar, ndërsa përdorimi i telefonave dhe kompjuterëve lejohet vetëm në sallën e shtypit, ku seanca transmetohet njëkohësisht.⁷ Gjykata Penale Ndërkombëtare ndjek të njëjtën logjikë: pajisjet elektronike të çdo lloji nuk lejohen në galerinë publike të sallës së gjyqimit dhe depozitohen paraprakisht në kabina të posaçme.⁸
32. Rregullat zyrtare të **Gjykatës Penale Ndërkombëtare** në Hagë parashikojnë një regjim të posaçëm dhe të rreptë për pajisjet elektronike në galeritë e sallave të gjyqit. Në këto ambiente lejohen vetëm blloku i shënimeve dhe stilolapsi, ndërsa kamerat, telefonat celularë, laptopët dhe pajisjet e tjera elektronike nuk lejohen të futen në sallat e gjyqit dhe duhet të depozitohen në dollapët e posaçëm të ruajtjes.⁹ Për më tepër, filmimi dhe fotografimi brenda godinës së Gjykatës janë, si rregull, të ndaluara jashtë zonave të posaçme të Qendrës së Medias.¹⁰
33. Këto krahasime marrin domethënie të veçantë për GJKKO-në, pasi nëse gjykatat ndërkombëtare, që shqyrtojnë kryesisht çështje ligji, kanë zgjedhur të zbatojnë kufizime të tilla, atëherë ekziston një arsye edhe më e fortë që një gjykatë fakti, ku administrohen drejtpërdrejt provat dhe dëshmitë në procedime me rrezik të lartë, të aplikojë masa sigurie të paktën të njëjtit nivel, madje edhe më të avancuara, kur këtë e diktojnë natyra e juridiksionit të saj.

⁷ European Court of Human Rights (Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut), "Public hearings at the European Court of Human Rights" ("Seancat publike në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut"), seksioni "General information — Rules of security and conduct" ("Informacion i përgjithshëm — Rregullat e sigurisë dhe të sjelljes"): https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/press_public_hearings_eng

⁸ International Criminal Court (Gjykata Penale Ndërkombëtare), "Rules of Decorum" ("Rregullat e sjelljes"): <https://www.icc-cpi.int/visit/rules-of-decorum>

⁹ International Criminal Court (Gjykata Penale Ndërkombëtare), "ICC Premises — Rules of Decorum" ("Ambientet e ICC-së — Rregullat e sjelljes"), seksioni "Courtroom gallery" ("Galeria e sallës së gjyqit") — mbi ndalimin e çantave dhe të të gjitha llojeve të pajisjeve elektronike në galerinë e sallës së gjyqit dhe detyrimin për depozitim të tyre në dollapët e posaçëm të ruajtjes: <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/ICCRulesofDecorumENGA4.pdf>

¹⁰ International Criminal Court (Gjykata Penale Ndërkombëtare), "Practical information for the media" ("Informacion praktik për median") — mbi ndalimin e filmimit dhe fotografimit brenda godinës së Gjykatës, me përjashtim të ambienteve të posaçme të Qendrës së Medias, si dhe sigurimin nga Gjykata të materialeve audiovizive të procedimeve: <https://www.icc-cpi.int/news/ntaganda-case-trial-chamber-vi-deliver-judgment-8-july-2019>

34. Nga ana tjetër, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë, në Opinionin nr. 8 (2013) për marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve dhe medias, e trajton transparencën së bashku me detyrimet për procesin e drejtë, prezumimin e pafajësisë, privatësinë, konfidencialitetin dhe autoritetin e gjyqësorit.¹¹ Këto instrumente nuk e ndërtojnë transparencën mbi një të drejtë të pakushtëzuar për regjistrim privat nga salla, por mbi balancimin e aksesit publik me procesin e drejtë, privatësinë, konfidencialitetin dhe autoritetin e gjyqësorit. Udhëzuesi i CEPEJ(2018)15 për komunikimin me median dhe publikun nga gjykatat dhe autoritetet e prokurorisë mbështet po ashtu kanale të organizuara, të parashikueshme dhe profesionale komunikimi,¹² plotësisht në përputhje me modelin sipas të cilit publiciteti garantohet nga aksesit në seancë dhe informacioni institucional, pa e kthyer sallën në hapësirë regjistrimi ose transmetimi të pakontrolluar.
35. Të njëjtin standard ndjekin edhe disa prej sistemeve më të konsoliduara gjyqësore të vendeve të zhvilluara si, për shembull:
- i. **Shtetet e Bashkuara të Amerikës:** Gjykatat federale amerikane zbatojnë regjime të diferencuara, deri në ndalimin e plotë të futjes së telefonave celularë dhe pajisjeve elektronike në godinën e gjykatës. Në Gjykatën Federale të Distriktit Verior të Ioëa-s (*U.S. District Court for the Northern District of Iowa*), telefonat celularë dhe pajisjet elektronike të ngjashme **nuk lejohen në godinën e gjykatës**; personi që paraqitet me një pajisje të tillë nuk lejohet të hyjë dhe i kërkohet ta largojë atë nga ndërtesa.¹³ Një regjim i ngjashëm, por i diferencuar sipas kategorisë së përdoruesit, zbatohet nga Gjykata Federale e Apelit për Qarkun e Katërt (*U.S. Court of Appeals for the Fourth Circuit*): vizitorëve u ndalohet, në parim, të sjellin pajisje elektronike në gjykatë, ndërsa avokatëve dhe stafit të tyre u lejohet posedimi i telefonave, tabletëve dhe laptopëve vetëm pas kontrollit të sigurisë; në sallën e gjyqit pajisjet duhet të jenë të fikura, përveç rasteve të autorizuara shprehimisht. Gjykata rezervon gjithashtu të drejtën të vendosë kufizime edhe më të forta kur këtë e kërkojnë siguria, mbrojtja ose integriteti i procesit gjyqësor, ndërsa shkelja mund të sjellë largimin nga salla ose godina, gjobë apo sanksione të tjera.¹⁴ Në nivel federal, politika e përgjithshme ndalon fotografimin dhe transmetimin e procedimeve penale,

¹¹ Consultative Council of European Prosecutors (Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë – CCPE), *Opinion No. 8 (2013) "on relations between prosecutors and the media"* ("Opinion nr. 8 (2013) mbi marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve dhe medias"): <https://rm.coe.int/16805c6d42>

¹² European Commission for the Efficiency of Justice (Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë – CEPEJ), dokumenti CEPEJ(2018)15, *"Guide on communication with the media and the public for courts and prosecution authorities"* ("Udhëzues për komunikimin me median dhe publikun për gjykatat dhe organet e prokurorisë"): <https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe>

¹³ United States District Court for the Northern District of Iowa (Gjykata Federale e Shteteve të Bashkuara për Distriktin Verior të Iowa-s), *"Are electronic devices (cell phones) allowed in the courthouse?"* ("A lejohen pajisjet elektronike (telefonat celularë) në godinën e gjykatës?") — mbi ndalimin e telefonave celularë dhe pajisjeve elektronike të ngjashme në godinën e gjykatës: <https://www.iand.uscourts.gov/content/are-electronic-devices-cell-phones-allowed-courthouse>

¹⁴ United States Court of Appeals for the Fourth Circuit (Gjykata Federale e Apelit e Shteteve të Bashkuara për Qarkun e Katërt), *"Electronic Device Policy"* ("Politika për pajisjet elektronike") — mbi ndalimin e pajisjeve elektronike për vizitorët, regjimin e posaçëm për avokatët dhe stafin e tyre, kontrollin e sigurisë dhe mundësinë e vendosjes së kufizimeve të mëtejshme për arsye sigurie ose për mbrojtjen e integritetit të procesit gjyqësor: <https://www.ca4.uscourts.gov/oral-argument/visiting-the-court/electronic-device-policy>

ndërsa udhëzuesi zyrtar për median sqaron se ky ndalim përfshin edhe regjistrimin nëpërmjet telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike personale; gjyqtari mund të ndalojë gjithashtu *live blogging* ose përdorimin e rrjeteve sociale nga salla.¹⁵

- ii. **Gjermania:** Praktika e gjykatave të larta gjermane konfirmon se mbajtja dhe përdorimi i pajisjeve elektronike në sallën e gjykimit i nënshtrohet kontrollit të gjykatës. **Bundesgerichtshof (Gjykata Federale e Drejtësisë)**, në një çështje penale me interes publik, ka ndaluar për publikun mbajtjen në sallë të telefonave celularë, pajisjeve fotografike, audio-video dhe laptopëve, duke kërkuar depozitimin e tyre pranë kontrollit të hyrjes; ndërsa përfaqësuesve të akredituar të medias u lejohej përdorimi i kompjuterëve vetëm *offline*, pa telefonata, mesazhe apo akses në internet.¹⁶ Edhe **Bundesverfassungsgericht (Gjykata Kushtetuese Federale)** ndalon në sallë telefonatat, mesazhet, përdorimin e rrjeteve sociale dhe transmetimin ose marrjen e të dhënave, duke lejuar, në kushte të përcaktuara, përdorimin *offline* të kompjuterëve nga përfaqësuesit e medias.¹⁷ **Praktika gjermane tregon kështu se gjykata mund të përcaktojë, sipas kategorisë së përdoruesit dhe kërkesave të sigurisë e të administrimit të seancës, jo vetëm mënyrën e përdorimit, por edhe mbajtjen dhe depozitimin e pajisjeve elektronike.**
- iii. **Franca:** neni 38 ter i ligjit të 29 korrikut 1881 "për lirinë e shtypit" ndalon që, që nga çelja e seancës, të përdoret çdo pajisje e aftë të regjistrojë, fiksojë ose transmetojë fjalën ose imazhin. Shkelja dënohet me deri në dy muaj burgim dhe gjobë deri në 4 500 euro dhe mund të shoqërohet me konfiskimin e pajisjes. Kushtetutshmëria e këtij ndalimi është konfirmuar shprehimisht nga Këshilli Kushtetues Francez, si masë që mbron standardin kushtetues të administrimit të drejtësisë.¹⁸ Zbatimi praktik i normës është konkret dhe gjykatat franceze kanë pasur shembuj ku kanë dënuar dhe konfiskuar telefonin e personave që kanë filmuar seanca me pajisjen e tyre.¹⁹

¹⁵ Administrative Office of the United States Courts (Zyra Administrative e Gjykatave të Shteteve të Bashkuara), "A Journalist's Guide to Federal Courts" ("Udhëzues për gazetarët mbi gjykatat federale"), seksioni "Federal Court Media Basics" ("Bazat e marrëdhënieve me median në gjykatat federale") — mbi ndalimin e fotografimit, regjistrimit dhe transmetimit të procedimeve gjyqësore nëpërmjet telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike, si dhe kompetencën e gjyqtarit për të kufizuar raportimin në kohë reale dhe përdorimin e rrjeteve sociale nga salla e gjyqit: <https://www.uscourts.gov/data-news/reports/handbooks-manuals/a-journalists-guide-federal-courts/federal-court-media-basics-journalists-guide>

¹⁶ Bundesgerichtshof (Gjykata Federale e Drejtësisë e Gjermanisë), *Akkreditierungsbedingungen für Medienvertreterinnen und Medienvertreter sowie Hinweise für Bürgerinnen und Bürger*, Njoftimi nr. 209/2024, 5 nëntor 2024, çështja penale 2 StR 54/24.

¹⁷ Bundesverfassungsgericht (Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë), *Mündliche Verhandlung in Sachen "Rundfunkfinanzierung II"*, Njoftimi nr. 29/2026, seksioni *Ergänzende Regelungen für den Sitzungssaal*.

¹⁸ Conseil Constitutionnel (Këshilli Kushtetues i Francës), portali QPC 360, "Enregistrement des audiences des juridictions" ("Regjistrimi i seancave të juridiksioneve") — mbi nenin 38 ter të ligjit të 29.07.1881: <https://qpc360.conseil-constitutionnel.fr/enregistrement-audiences-juridictions>

¹⁹ France Bleu (Radio France), "Il est interdit de filmer une audience au tribunal, un prévenu l'a appris à ses dépens à Valence" ("Ndalohej filmimi i një seance gjyqësore; një i pandehur e mësoi këtë me kosto në Valence"): <https://www.francebleu.fr/infos/insolite/il-est-interdit-de-filmer-une-audience-au-tribunal-un-dromois-l-a-appris-a-ses-dépens-1542386655>

- iv. **Italia:** neni 147 i dispozitave zbatuese të Kodit të Procedurës Penale italian ndalon si parim regjistrimin fotografik, zanor ose audioviziv të seancës, **duke e lejuar këtë vetëm me autorizim të posaçëm të gjykatës dhe zakonisht me pëlqimin e palëve**, kur ekziston interes shoqëror i rëndësishëm për njohjen e gjykimit.²⁰
- v. **Mbretëria e Bashkuar – Central Criminal Court (Old Bailey):** Në Central Criminal Court të Londrës (Old Bailey), një nga gjykatat kryesore penale të Anglisë dhe Uellsit, ku zhvillohen edhe gjykime penale të profilit të lartë, **zbatohet një regjim veçanërisht i rreptë për pajisjet elektronike ku pajisjet elektronike nuk lejohen dhe në hyrje të galerive publike nuk ofrohet as mundësi për depozitimin apo ruajtjen e tyre.**²¹ Politikat e telefonave celularë në Central Criminal Court evidentojnë se ndalimi i telefonave dhe pajisjeve të tjera inteligjente në galeritë publike është vlerësuar si **“e përshtatshme, proporcionale, e arsyeshme dhe e ligjshme”**, duke u mbështetur edhe në një vlerësim të posaçëm të rrezikut të kryer nga City of London Police.²²
- vi. **Irlanda:** Udhëzimi i Praktikës CC20 "Use of cameras and electronic devices in court", miratuar bashkërisht nga kryetarët e të gjitha shkallëve të gjyqësorit irlandez (2018), ndalon si parim fotografimin, filmimin dhe regjistrimin e seancave, dhe e kufizon transmetimin e teksteve në kohë reale vetëm te avokatët me çështje në gjykim dhe te gazetarët e akredituar, në modalitet të heshtur dhe vetëm nëse nuk pengon procesin.²³ **Vetë udhëzuesit praktikë për publikun konfirmojnë se telefonat nuk përdoren në sallë dhe duhen fikur ose vënë në heshtje**, ndërsa mediat kanë raportuar edhe raste konkrete të konfiskimit të telefonave nga gjykata kur aro nuk janë fikur në sallë.²⁴
36. Kjo panoramë krahasuese tregon se, pavarësisht dallimeve ndërmjet sistemeve juridike dhe intensitetit të masave të zbatuara, **nuk evidentohet një standard sipas të cilit pjesëmarrësit në proces gëzojnë një të drejtë të pakushtëzuar për të mbajtur ose përdorur pajisje elektronike personale në sallën e gjykimit.** Përkundrazi, modalitetet e mbajtjes dhe përdorimit të tyre i nënshtrohen rregullave të

²⁰ Brocardi.it, "Riprese audiovisive dei dibattimenti" ("Regjistrimet audiovizive të shqyrtimit gjyqësor") — neni 147 i dispozitave zbatuese të Kodit të Procedurës Penale italian: <https://www.brocardi.it/disposizioni-per-attuazione-codice-procedura-penale/titolo-i/capo-xi/art.147.html>

²¹ His Majesty's Courts & Tribunals Service (Shërbimi i Gjykatave dhe Tribunaleve të Mbretërisë së Bashkuar), Central Criminal Court (Old Bailey), rregullat zyrtare për hyrjen dhe sigurinë në gjykatë, seksioni "Security arch" ("Harku i sigurisë") — mbi ndalimin e pajisjeve elektronike dhe mungesën e ambienteve për ruajtjen e tyre në hyrje të galerive të publikut: <https://www.find-court-tribunal.service.gov.uk/courts/central-criminal-court>

²² City of London Corporation, Courts Sub (Policy and Resources) Committee, "Mobile Phone Policy Update" ("Përditësim i politikës për telefonat celularë"), 9 shkurt 2017 — mbi ndalimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera regjistruese në galeritë e publikut të Central Criminal Court (Old Bailey), si dhe vlerësimin e këtij kufizimi si masë e përshtatshme, proporcionale, e arsyeshme dhe e ligjshme: <https://democracy.cityoflondon.gov.uk/documents/s75387/Committee%20Report%20Mobile%20phones%20CCC%20UpdateFinal.pdf>

²³ Courts Service of Ireland (Shërbimi i Gjykatave të Irlandës), Practice Direction CC20, "Use of cameras and electronic devices in court" ("Udhëzimi i Praktikës CC20 – Përdorimi i kamerave dhe i pajisjeve elektronike në gjykatë"), në fuqi që nga 26.11.2018: <https://www.courts.ie/practice-directions/full-practice-direction?url=use-of-cameras-and-electronic-devices-in-court-circuit>

²⁴ KOD Lyons Solicitors, "Going to Court Guide" ("Udhëzues për paraqitjen në gjykatë"): <https://kodlyons.ie/going-to-court-guide/>; shih edhe Irish Examiner, "Mobile phones confiscated in court" ("Telefona celularë të konfiskuar në gjykatë"): <https://www.irishexaminer.com/ncs/arid-30915067.html>

vendosura nga gjykata, të diferencuara sipas natyrës së juridiksionit, kategorisë së përdoruesit dhe kërkesave të sigurisë e të administrimit të rregullt të drejtësisë.

- **Lidhur me respektimin e solemnitetit të gjykimit, të drejtës për t'u dëgjuar, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së**

37. Solemniteti i seancës gjyqësore nuk përbën një kërkesë thjesht formale apo protokollare, por është pjesë e kushteve institucionale që mundësojnë zhvillimin e rregullt të procesit. Gjykimi kërkon një mjedis të qetë, të kontrolluar dhe të përshtatshëm me natyrën e funksionit që ushtrohet, në të cilin gjyqtarët, palët, mbrojtësit, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë të mund të ushtrojnë funksionet e tyre pa ndërhyrje, presion apo shpërqendrim të panevojshme. Në këtë kuptim, solemniteti nuk është qëllim në vetvete, por një nga kushtet funksionale që i shërben administrimit të rregullt të drejtësisë dhe zhvillimit efektiv të gjykimit.
38. Jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk ka përcaktuar një standard specifik mbi përdorimin e telefonave celularë në sallën e gjykimit, por ka konsoliduar parimin se mbrojtja e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe administrimi i rregullt i drejtësisë përbëjnë interesa legjitime të njohura nga Konventa. Në *Prager and Oberschlick kundër Austrisë*, Gjykata theksoi se gjyqësori, si garantues i drejtësisë dhe i një vlere themelore të shtetit të së drejtës, duhet të gëzojë besimin e publikut për të përmbushur funksionet e tij; në *Worm kundër Austrisë* e lidhi nocionin e “autoritetit të gjyqësorit” me besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë te publiku dhe te personat që u drejtohen atyre; ndërsa në *Bédat kundër Zvicrës [Dhoma e Madhe]* njohu rëndësinë e mbrojtjes së integritetit të procedimit penal, prezumimit të pafajësisë dhe autoritetit e paanshmërisë së gjyqësorit. Këto standarde nuk përcaktojnë vetë modalitetet konkrete të përdorimit të pajisjeve elektronike në sallë, por konfirmojnë legjitimitetin e interesave që neni 76 i Rregullores synon të mbrojë.
39. Kjo nevojë paraqitet me rëndësi të posaçme në GJKKO, si gjykatë fakti, ku administrohen drejtpërdrejt provat, dëgjohen të pandehurit, dëshmitarët dhe ekspertët dhe zhvillohet debati kontradiktor mbi materialin provues. Në këtë fazë, ruajtja e qetësisë, përqendrimit dhe kontrollit institucional të sallës synon të krijojë kushtet që prova të administrohet dhe debati procedural të zhvillohet në mënyrë të rregullt, pa ndërhyrje apo ndikime të jashtme.
40. Kufiri dhe, njëkohësisht, kriteri për vlerësimin e këtyre rregullave gjendet në **nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, të cilët garantojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuadër, dëgjimi efektiv, kontradiktoriteti dhe barazia e armëve kërkojnë që palëve t'u sigurohet mundësi reale dhe efektive për të marrë pjesë në proces, për të ndjekur zhvillimin e procedimit, për t'u njohur me provat dhe argumentet e palës tjetër, për t'i kundërshtuar ato dhe për të paraqitur në mënyrë efektive qëndrimin e tyre.
41. Në *Nideröst-Huber kundër Zvicrës* dhe *Mantovanelli kundër Francës*, GJEDNJ-ja e ka lidhur karakterin kontradiktor të procesit me mundësinë e palëve për t'u njohur dhe

për të komentuar provat dhe parashtrirat që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës. Në *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Gjykata formuloi standardin e barazisë së armëve, sipas të cilit secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj, përfshirë provat, në kushte që nuk e vendosin në disavantazh thelbësor kundrejt palës tjetër.

42. Pikërisht mbi këto standarde kushtetuese dhe konvencionale duhet vlerësuar edhe neni 76 i Rregullores. Pyetja juridikisht relevante nuk është nëse mbrojtësi disponon në sallën e gjykimit një pajisje teknologjike të caktuar, por nëse kufizimi i saj i **ruan mundësinë reale dhe efektive për të ndjekur procesin, për t'u njohur me provat dhe për t'i kundërshtuar ato, për të paraqitur argumentet e tij, për të komunikuar në mënyrë konfidenciale me të mbrojturin dhe për të përdorur mjetet e nevojshme për ushtrimin e funksionit procedural**. Në kushtet kur Rregullorja i garanton këto mundësi, përfshirë përdorimin e kompjuterit portativ për mbajtjen dhe konsultimin e akteve, provave, dosjes elektronike dhe jurisprudencës, kufizimi i mbajtjes së telefonit celular nuk mund të barazohet me kufizimin e dëgjimit efektiv, të kontradiktoritetit apo të barazisë së armëve.

- **Lidhur me pretendimin e parashtruar në shkresën tuaj se telefoni celular është “mjet pune” dhe “studio lëvizëse” e avokatit**

43. Neni 76, pika 1, i Rregullores e formulon ndalimin në mënyrë të përgjithshme, duke përcaktuar se, për garantimin e sigurisë, rendit dhe solemnitetit të seancës, administrimit të rregullt të drejtësisë, mbrojtjes së procesit të rregullt ligjor, të drejtave të palëve, konfidencialitetit të komunikimeve dhe të dhënave personale, “ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe i pajisjeve të tjera elektronike në sallën e gjykimit”, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga Rregullorja. Për më tepër, zbatimi i një rregulli të përgjithshëm të sallës, i cili synon të sigurojë qetësinë, përqendrimin dhe zhvillimin e pandërprerë të procesit dhe që zbatohet njëjloj ndaj gjyqtarit, prokurorit, mbrojtësit dhe pjesëmarrësve të tjerë, duhet të vlerësohet në tërësinë e garancive që ofron procesi. **Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë efektivitetin e ushtrimit të të drejtave procedurale; ato nuk përcaktojnë se cilat pajisje teknologjike përmbushin kriteret e ushtrimit efektiv të këtyre të drejtave.**
44. Norma, pra, nuk e ndërton kufizimin mbi statusin e personit që posedon pajisjen, por mbi praninë dhe funksionalitetet e pajisjes brenda sallës dhe mbi rreziqet që ato mund të krijojnë për procesin.
45. Për këtë arsye, ndalimi zbatohet ndaj të gjithë të pranishmëve pa dallim, përfshirë gjyqtarët, prokurorët, avokatët, palët, përfaqësuesit e medias dhe publikun. Ky element është me rëndësi për vlerësimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit të masës. Kështu telefoni mund të përdoret profesionalisht nga avokati, por po aq mund të jetë mjet pune për prokurorin, gjyqtarin apo gazetarin. Nëse vetëm cilësimi i tij si “mjet pune” do të krijonte një përjashtim nga rregulli, i njëjti përjashtim do të duhej të njihej për çdo kategori profesionale të pranishme në sallë, duke e privuar kufizimin nga efektiviteti i tij. Fakti që edhe gjyqtari që drejton procesin dhe prokurori që

ushtron ndjekjen penale i nënshtrohen të njëjtit kufizim përjashton, në vetvete, idenë se norma synon të vendosë mbrojtjen ose ndonjë aktor tjetër procedural në pozitë të pafavorshme.

46. Vlerësimi juridik duhet të mbështetet, përkundrazi, në funksionin konkret të pajisjes gjatë seancës, në domosdoshmërinë e përdorimit të saj për ushtrimin e një të drejte procedurale dhe në rrezikun që funksionalitetet e saj krijojnë për zhvillimin e rregullt të procesit. Siç u citua më lart, modele të ndryshme të gjykatave të shteteve të konsoliduara për pajisjet portative të komunikimit ndjekin pikërisht një qasje të tillë.²⁵ Kriteri relevant nuk është, pra, nëse pajisja mund të përdoret për punë, por nëse përdorimi konkret i saj gjatë seancës është proceduralisht i nevojshëm dhe i pajtueshëm me kërkesat e sigurisë dhe integritetit të procesit.
47. Në këtë pikë duhet dalluar ndalimi i telefonit celular nga lejimi, në kushtet e përcaktuara nga Rregullorja, i kompjuterit portativ për mbajtjen dhe konsultimin e akteve, provave, jurisprudencës dhe dokumenteve elektronike gjatë seancës. Ky dallim nuk është formal, por qëndron te funksioni kryesor për të cilin pajisja përdoret në sallën e gjyqimit dhe te rreziku që funksionalitetet e saj bartin për procesin. Kompjuteri portativ lejohet jo sepse gëzon në mënyrë abstrakte statusin e “mjetit të punës”, por sepse përdorimi i tij lidhet me një nevojë konkrete dhe të identifikueshme procedurale: konsultimin dhe përdorimin e materialit të çështjes. Telefoni celular, përkundrazi, përmbledh në të njëjtën pajisje funksione të menjëhershme komunikimi, regjistrimi, fotografimi dhe transmetimi, të cilat nuk janë në vetvete të nevojshme për ushtrimin e të drejtave procedurale gjatë zhvillimit të seancës dhe që lidhen drejtpërdrejt me rreziqet që neni 76 i Rregullores synon të parandalojë.
48. Të njëjtin dallim funksional e bën edhe Gjykata Kushtetuese. Neni 34, pika 3, shkronja “e”, i Rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese diferencon ndërmjet përdorimit të telefonit celular dhe përdorimit të kompjuterit portativ gjatë seancës, duke mos i trajtuar të gjitha pajisjet elektronike si një kategori homogjene. Rëndësia e këtij krahasimi qëndron pikërisht në kriterin e përdorur: lejueshmëria e një mjeti teknologjik në sallën e gjyqit nuk përcaktohet vetëm nga fakti se ai mund të shërbejë profesionalisht, por nga funksioni për të cilin përdoret në proces dhe nga pajtueshmëria e këtij përdorimi me zhvillimin e rregullt të seancës.
49. Po kështu, nuk gjen mbështetje në standardet e procesit të rregullt ligjor pretendimi se telefoni celular i avokatit duhet të konsiderohet “studio e lëvizshme” e tij dhe se, për këtë arsye, avokati duhet të ketë të drejtë ta mbajë me vete në sallën e gjyqit. Ky argument ngatërron dy hapësira juridikisht dhe funksionalisht të ndryshme: hapësirën private të ushtrimit të profesionit të avokatit dhe hapësirën institucionale në të cilën ushtrohet funksioni gjyqësor. Studio e avokatit, qoftë fizike, qoftë e mbështetur në

²⁵ Administrative Office of the United States Courts (Zyra Administrative e Gjykatave të Shteteve të Bashkuara), “Guide to Judiciary Policy, Volume 10, Chapter 5 — Portable Communication Devices in the Courthouse” (“Udhëzuesi për Politikën e Gjyqësorit, Vëllimi 10, Kreu 5 — Pajisjet portative të komunikimit në godinën e gjykatës”), §§ 540.10–540.30. Në veçanti, § 540.20 evidenton funksionalitetet e telefonave inteligjentë për akses në internet, regjistrim dhe transmetim në kohë reale, ndërsa § 540.30 referon politikën e gjykatave federale që ndalojnë futjen e këtyre pajisjeve ose ua lejojnë vetëm kategorive të caktuara, përfshirë avokatët, duke vendosur kufizime mbi përdorimin e tyre: <https://www.uscourts.gov/sites/default/files/guide-vol10-ch05.pdf>

pajisjet e tij personale, është mjedisi ku ai organizon punën, përgatit strategjinë e mbrojtjes, studion dosjen, komunikon me klientin dhe përdor mjetet profesionale sipas organizimit të tij. Salla e gjyqit, përkundrazi, është hapësira në të cilën zhvillohet një procedurë e rregulluar nga ligji, administrohet prova, dëgjohen palët dhe dëshmitarët, ushtrohet kontradiktoriteti dhe gjykata garanton rendin, solemnitetin, sigurinë dhe integritetin e procesit. **Cilësimi i një pajisjeje personale si 'studio' nuk i shtrin asaj regjimin juridik të studios së avokatit brenda sallës së gjyqimit, e cila është një mjedis institucional i administruar nga gjykata sipas ligjit.**

50. Këtë dallim e konfirmon vetë struktura e nenit 6 të KEDNJ-së. Neni 6 § 3 (b) i garanton të pandehurit "kohën dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes", ndërsa neni 6 § 3 (c) garanton të drejtën për t'u mbrojtur nëpërmjet një avokati. Këto garanci mbrojnë përgatitjen dhe ushtrimin efektiv të mbrojtjes; ato nuk krijojnë një të drejtë të pakufizuar të avokatit për të mbajtur në sallën e gjyqit çdo pajisje personale me pretendimin se ajo mishëron studion e tij profesionale. Edhe Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm nr. 32 për nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, e konkretizon nocionin e "**lehtësive të përshtatshme**" duke e lidhur atë me aksesin në dokumente dhe prova dhe me mundësinë e komunikimit konfidencial me avokatin, jo me një të drejtë për përdorimin e çdo pajisjeje personale brenda sallës së gjyqit.²⁶
51. Jurisprudenca e GJEDNJ-së e bën edhe më të qartë funksionin e sallës së gjyqit. Gjykata ka përcaktuar se, në procesin penal, seanca përpara gjykatës së shkallës së parë duhet t'i mundësojë të pandehurit që çështja e tij të "dëgjohet", përfshirë mundësinë për të dhënë shpjegime në mbrojtje të vet, për të dëgjuar provat kundër tij dhe për të pyetur dëshmitarët. Pra, funksioni juridik i sallës nuk është vazhdimi i veprimtarisë private të studios së avokatisë me mjete të zhvendosura brenda saj, por realizimi institucional i shqyrtimit gjyqësor nën drejtimin e gjykatës. Brenda kësaj hapësire, mënyra e ushtrimit të veprimtarisë profesionale të secilit pjesëmarrës, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ekspertit etj., i nënshtrohet rregullave që garantojnë zhvillimin e rregullt të procesit, pavarësisht nga pajisjet që secili prej tyre përdor jashtë saj.
52. As standardet ndërkombëtare mbi pavarësinë e profesionit të avokatit nuk çojnë në një përfundim tjetër. Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Avokatëve garantojnë që avokatët të mund t'i këshillojnë dhe përfaqësojnë klientët e tyre në përputhje me ligjin dhe standardet profesionale, pa kufizime, ndikime, presione ose ndërhyrje të papërshtatshme²⁷. Në të njëjtën frymë, Rekomandimi nr. R(2000)21 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës kërkon që avokatët të mund të ushtrojnë profesionin e tyre pa diskriminim dhe pa ndërhyrje të papërshtatshme²⁸.

²⁶ United Nations Human Rights Committee (Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut), *General Comment No. 32 (2007)*, "Article 14: Right to equality before courts and tribunals and to a fair trial" ("Komenti i Përgjithshëm nr. 32 (2007), Neni 14: E drejta për barazi përpara gjykatave dhe për një proces të rregullt ligjor"), dokumenti CCPR/C/GC/32, datë 23.08.2007, paragrafët 32–34.

²⁷ United Nations (Kombet e Bashkuara), *"Basic Principles on the Role of Lawyers"* ("Parimet Bazë mbi Rolin e Avokatëve"), miratuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Autorëve të Veprave Penale, Havanë, 27 gusht – 7 shtator 1990, Parimet 16 dhe 21.

²⁸ Council of Europe, Committee of Ministers (Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave), *Recommendation No. R(2000)21 "on the freedom of exercise of the profession of lawyer"* ("Rekomandimi nr. R(2000)21 për shtetet anëtare

Garancia është, pra, kundër ndërhyrjes së papërshtatshme në funksionin e mbrojtjes; ajo nuk e përjashton avokatin nga rregullat e organizimit, sigurisë dhe solemnitetit që gjykata zbaton ndaj të gjithë pjesëmarrësve në seancë, dhe as nuk e shndërron pajisjen e tij personale në një hapësirë të imunizuar prej tyre.

53. Në këtë kuptim, të konsideruarit e telefonit celular si "studio e lëvizshme" përmbys raportin juridik ndërmjet profesionit të avokatit dhe rolit të gjykatës. Nuk është studio e avokatit që zhvendoset juridikisht brenda sallës së gjyqit sa herë që ai hyn në të me pajisjet e veta; është avokati që, kur hyn në sallë, ushtron profesionin e tij brenda një hapësire institucionale të administruar nga gjykata dhe sipas rregullave të procesit. Pavarësia profesionale i garanton atij lirinë dhe mjetet e nevojshme për të mbrojtur klientin, përfshirë, sipas nenit 77 të Rregullores, kompjuterin portativ me dosjen elektronike, aktet, provat dhe jurisprudencën; ajo nuk i jep të drejtën të mos respektojë rregullat e përgjithshme të sallës duke i rikualifikuar pajisjet personale si zgjatim të "studios" së tij ligjore.

- **Garancitë që Rregullorja parashikon për ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes**

54. Pretendimi se Rregullorja pengon ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e saj, e cila parashikon shprehimisht mjete dhe garanci alternative për ushtrimin efektiv të funksioneve procedurale të mbrojtjes:

- a) **Neni 77, pikat 1 dhe 2, të Rregullores** — prokurorët, të pandehurit, viktimat dhe avokatët mbajnë me vete dhe përdorin kompjuterë portativë (laptopë) për ushtrimin e funksioneve të tyre procedurale, në modalitet pa zë. Kjo mundëson mbajtjen dhe konsultimin e akteve, provave, jurisprudencës dhe shënimeve gjatë seancës.
- b) **Neni 88** — Gjykata siguron ambient të posaçëm për komunikimin e të arrestuarit ose të paraburgosurit me mbrojtësin, në kushte që garantojnë konfidencialitetin efektiv. Në këtë ambient ndalohet çdo përgjim, dëgjim ose monitorim i përmbajtjes së komunikimit avokat-klient; mbikëqyrja mund të jetë vetëm vizuale dhe vetëm për qëllime sigurie.
- c) **Neni 73, pika 8** — kryesuesi i trupit gjykues autorizon hyrjen dhe daljen nga salla për nevoja të procesit, çka mundëson çdo komunikim urgjent jashtë sallës ose gjatë pushimit të seancës.
- d) **Neni 31, pika 6, dhe neni 56** — ndalimi vlen për sallën e gjykimit; në hollin e pritjes dhe në zonat publike telefoni mund të mbahet, për sa kohë nuk cenon rendin, qetësinë, sigurinë ose privatësinë e personave.
- e) **Neni 77, pika 4** — kompetenca për të kufizuar ose lejuar përdorimin e pajisjeve i takon kryesuesit të trupit gjykues, i cili e ushtron atë duke vlerësuar rrethanat konkrete të çdo seance.

– Për lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit"), miratuar më 25.10.2000, Parimi I: <https://www.coe.int/en/web/cdcj/recommendations-resolutions-guidelines>.

55. Në këtë kuadër, kufizimi nuk prek thelbin e së drejtës së mbrojtjes, por vetëm mënyrën e ushtrimit të saj, duke ofruar njëkohësisht përdorimin e mjeteve të tjera të përshtatshme që i sigurojnë mbrojtjes mundësinë e ushtrimit efektiv të funksionit të saj dhe nuk cenojnë sigurinë dhe solemnitetin e seancës gjyqësore. Standardet evropiane kërkojnë që mbrojtja të ketë kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për përgatitje; ato nuk kërkojnë që kjo të realizohet përmes telefonit personal gjatë seancës.

• **Zgjidhje praktike në zbatimin e nenit 76 të Rregullores së GJKKO-së**

56. Për ta bërë sa më të prekshëm zbatimin praktik të këtij rregullimi dhe për të shmangur çdo vështirësi operative për mbrojtjen, GJKKO-ja sqaron dhe konfirmon si më poshtë:

- i. **Depozitimi është i përkohshëm, i organizuar dhe i sigurt.** Telefoni celular depozitohet përpara hyrjes në sallën e gjykimit dhe tërhiqet menjëherë pas daljes prej saj.
- ii. **Kompjuteri portativ është plotësisht në dispozicion të mbrojtjes.** Mbrojtësi hyn në sallë me laptopin e tij dhe e përdor atë gjatë gjithë seancës, në modalitet pa zë, për dosjen elektronike, aktet, provat, jurisprudencën, kërkesat dhe shënimet. Për qëllime procedurale, kjo pajisje mbulon nevojat kryesore dokumentare dhe të konsultimit gjatë gjykimit.
- iii. **Komunikimi urgjent gjatë seancës është tërësisht i mundësuar.** Kur lind nevoja procedurale, mbrojtësi i drejtohet kryesuesit të trupit gjykues, i cili autorizon daljen nga salla sipas nenit 73, pika 8, ose shfrytëzohet pushimi i seancës.
- iv. **Komunikimi me klientin e ndaluar ose të paraburgosur është i garantuar.** Sipas nenit 88, të Rregullores, GJKKO-ja vë në dispozicion ambient të posaçëm ku sigurohet konfidencialiteti efektiv i takimit avokat-klient, me mbikëqyrje vetëm vizuale dhe vetëm për qëllime sigurie.
- v. **Zonat publike të GJKKO-së nuk preken nga ndalimi.** Në hollin e pritjes dhe në ambientet e tjera publike telefoni mbahet lirisht, për sa kohë nuk cenohen rendi, qetësia, siguria ose privatësia e personave.
- vi. **Zbatimi është uniform.** I njëjti rregull vlen për gjyqtarët, prokurorët, të pandehurit, viktimat, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, personelin e Gjykatës, median dhe publikun, pa asnjë regjim të diferencuar.

57. Për sa më sipër, GJKKO-ja çmon se neni 76 i Rregullores ka bazë të mjaftueshme ligjore, ndjek qëllime legjitime të lidhura me sigurinë dhe administrimin e rregullt të drejtësisë, zbatohet në mënyrë të përgjithshme dhe jodiskriminuese dhe, duke pasur parasysh garancitë alternative të parashikuara për ushtrimin efektiv të mbrojtjes, nuk tejkalon atë që është e nevojshme për realizimin e këtyre qëllimeve. Për rrjedhojë, në gjendjen aktuale, GJKKO-ja nuk konstaton bazë juridike ose faktike që të kërkojë rishikimin e këtij neni.

- **Lidhur me pretendimin e ngritur se ndalimi cenon Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Profesionit të Avokatit (CETS nr. 226) dhe nenet 339–341 të KPP-së**

58. Fillimisht vlen të saktësohet se Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Profesionit të Avokatit (CETS nr. 226) u hap për nënshkrim më 13 maj 2025 dhe se Republika e Shqipërisë e ka nënshkruar atë më 16 qershor 2026²⁹, pra e ka nënshkruar, por ende nuk e ka ratifikuar. Sipas nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, një marrëveshje ndërkombëtare bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe fiton epërsi mbi ligjet e vendit vetëm pas ratifikimit me ligj; vetë nënshkrimi krijon, sipas nenit 18 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve, vetëm detyrimin për të mos vepruar në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e traktatit deri në ratifikim, dhe jo detyrime të drejtpërdrejta e të zbatueshme brenda vendit. Për rrjedhojë, në gjendjen aktuale, kjo Konventë nuk mund të përdoret si bazë e drejtpërdrejtë ligjore për të kundërshtuar një dispozitë të brendshme siç është neni 76 i Rregullores. Megjithatë, GJKKO-ja çmon ta shqyrtojë pretendimin edhe në planin e përputhshmërisë materiale me Konventën.
59. Konventa duhet lexuar sipas objektit të saj: mbrojtja e profesionit të avokatit dhe e ushtrimit të tij në mënyrë të pavarur, pa diskriminim, pengesa ose ndërhyrje të papërshtatshme, sulme, kërcënime, ngacmime apo frikësim. Neni 6 i saj mbron të drejtat profesionale të avokatit, si dhënien e këshillimit, ndihmës dhe përfaqësimit; takimin dhe komunikimin me klientin; njohjen e rolit të avokatit nga gjykata; aksesin në materialet përkatëse; komunikimin me gjykatën; paraqitjen e kërkesave procedurale; pjesëmarrjen efektive në procedim; si dhe konfidencialitetin e takimeve, komunikimeve dhe materialeve të marrëdhënies avokat-klient. Telefoni celular nuk renditet si e drejtë autonome dhe as si mjet që gjykata është e detyruar ta lejojë në sallë.
60. Në Raportin Shpjegues në paragrafin 43, për nenin 6, pika 1. shkronja "f", shpjegohet se mundësia e avokatit për të hyrë dhe komunikuar me gjykatën nuk përjashton "kontrollet e arsyeshme të sigurisë" për hyrjen në ambientet e saj, as mundësinë e organit përkatës për të përcaktuar mjetet e komunikimit me të.³⁰
61. Paragrafi 45 kërkon pjesëmarrje efektive në procedim, ndërsa paragrafët 48 deri 50 mbrojnë takimet private dhe konfidencialitetin e komunikimeve dhe materialeve avokat-klient. Rregullorja për Sigurinë nuk autorizon leximin, kopjimin ose interceptimin e të dhënave të telefonit; ajo kërkon vetëm depozitimin e përkohshëm të pajisjes jashtë sallës. Për këtë arsye, nuk kemi ndërhyrje në sekretin profesional, por rregullim të pranishëm së një pajisjeje shumëfunktionale në një zonë të kontrolluar.
62. Neni 6, pika 4, i Konventës lejon vetë kufizime të të drejtave të parashikuara në pikat 1 deri 3, kur ato janë të parashikuara me ligj dhe të nevojshme në një shoqëri

²⁹ Council of Europe, Treaty Office (Këshilli i Evropës, Zyra e Traktateve) — statusi i nënshkrimeve të Konventës CETS nr. 226: Shqipëria e nënshkroi më 16.06.2026; deri në datën e kësaj shkrese, nuk figuron ende ratifikim: <https://www.coe.int/en/web/edcj/conventions>

³⁰ Council of Europe (Këshilli i Evropës), "Explanatory Report to the Convention on the Protection of the Profession of Lawyer (CETS No. 226)" ("Raporti Shpjegues i Konventës për Mbrojtjen e Profesionit të Avokatit"), paragrafët 43, 45 dhe 48–50: <https://rm.coe.int/1680b4c6c0>

demokratike. Sipas paragrafit 51 të Raportit Shpjegues, kërkohet aksesueshmëri dhe parashikueshmëri e normës, qëllim legjitim, arsye relevante e të mjaftueshme dhe proporcionalitet. Masa e parashikuar nga kjo Gjykatë e përmbush këtë test. Ajo ka bazë në kompetencat ligjore të organeve drejtuese të Gjykatës dhe në Kodin e Procedurës Penale, është përcaktuar në një rregullore të miratuar dhe publikuar; ndjek qëllime legjitime, sigurinë, rendin, solemnitetin, mbrojtjen e pjesëmarrësve, konfidencialitetin, të dhënat personale dhe integritetin e procesit; është e përshtatshme për të parandaluar regjistrimin, fotografimin, transmetimin dhe komunikimin e paautorizuar nga salla; është e kufizuar në vend dhe kohë, pasi zbatohet vetëm në sallën e gjykimit dhe pajisja kthehet pas daljes nga zona përkatëse; nuk cenon thelbin e mbrojtjes, sepse avokati hyn në seancë, komunikon me klientin, paraqet kërkesa dhe përdor materialet e çështjes; dhe parashikon alternativa e përjashtime, përfshirë laptopin për funksione procedurale.

Nenet 339–341 të KPP-së

63. Nga interpretimi literal, sistematik dhe teleologjik i dispozitave të mësipërme, evidentohet se ato ndodhen në të njëjtin seksion, por rregullojnë tri çështje të ndryshme: aksesin publik, përjashtimet nga publiciteti dhe drejtimin e rendin e seancës; asnjëra nuk rregullon një të drejtë për mbajtjen e pajisjeve elektronike në seancë gjyqësore.
64. Neni 339, pika 1, i KPP-së kërkon që seanca të jetë publike. Kuptimi juridik i publicitetit është mundësia reale e publikut për të hyrë dhe për të ndjekur drejtpërdrejt zhvillimin e seancës, brenda kapacitetit dhe rregullave të rendit e sigurisë; ai nuk përfshin të drejtën për të fotografuar, regjistruar, transmetuar, komunikuar në kohë reale ose për të futur çdo send të dëshiruar në sallë. Vetë pikat 2 dhe 3 të po këtij neni tregojnë se një seancë publike nuk është hapësirë pa kontroll: ligji përjashton kategori personash dhe ndalon personat e armatosur. Ndalimi i telefonit nuk prek statusin publik të seancës, sepse dyert mbeten të hapura dhe publiku, media dhe avokatët mund ta ndjekin atë.
65. Neni 340 i KPP-së përcakton rastet kur gjykata mund ose duhet të zhvillojë shqyrtimin me dyer të mbyllura. Ndalimi i telefonit nuk është vendim për zhvillimin me dyer të mbyllura dhe nuk prodhon efektin e një vendimi të tillë: ai nuk përjashton publikun, median, palët ose mbrojtësit dhe nuk kufizon mundësinë për të dëgjuar e vëzhguar seancën. Zhvillimi i seancës me dyer të mbyllura, e cila kufizon pjesëmarrjen e publikut, është e ndryshme nga një masë sigurie e sjelljeje brenda një seance që vazhdon të jetë publike.
66. Neni 341, pika 1, i KPP-së përcakton se seanca drejtohet nga kryetari i trupit gjykues dhe se urdhrat e tij për rendin dhe qetësinë janë të detyrueshëm për palët dhe pjesëmarrësit; pika 2 e ngarkon kryesuesin të marrë masa për autoritetin e gjykatës, solemnitetin, sigurinë në sallë dhe mbrojtjen e pjesëmarrësve. Në vlerësimin e GJKKO-së, këto kompetenca nuk kufizohen vetëm në reagimin pasi ka ndodhur një incident, por përfshijnë edhe marrjen e masave parandaluese të nevojshme për garantimin e sigurisë dhe zhvillimit të rregullt të seancës. Rregullorja standardizon

parapakisht një masë sigurie; neni 341 ruan autoritetin e kryesuesit për zbatimin e saj në seancën konkrete.

67. Rregullorja respekton plotësisht ndarjen e kompetencave: neni 7 përcakton se masat e sigurisë kanë karakter administrativ dhe nuk cenojnë kompetencat procedurale të trupit gjykues; neni 62 garanton komunikimin efektiv të të pandehurit me mbrojtësin; neni 65 garanton aksesin publik; nenet 73 dhe 74 konkretizojnë rendin dhe solemnitetin; neni 76 kufizon telefonat për arsyet e përcaktuara; ndërsa neni 77 u lejon avokatëve dhe subjekteve të tjera procedurale përdorimin e laptopëve për ushtrimin e funksioneve të tyre. Masa është e përgjithshme, parandaluese dhe proporcionale; nuk ka për objekt kontrollin e të dhënave apo komunikimeve profesionale dhe nuk e privon avokatin nga mjetet e nevojshme për mbrojtje.

• Përfundim

68. Për arsyet e parashtruara më sipër, GJKKO-ja çmon se ndalimi i mbajtjes dhe përdorimit të telefonave celularë në sallën e gjykimit përbën masë të ligjshme, të nevojshme dhe proporcionale, e cila:
- mbështetet në kompetencën që neni 46 i ligjit nr. 95/2016 i njeh Kryetarit të Gjykatës për drejtimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të sigurisë, si dhe në kuadrin e posaçëm që ky ligj përcakton për garantimin e sigurisë së mjedisve të Gjykatës, të personelit dhe të të dhënave të ndjeshme;
 - është në përputhje me kompetencat ligjore të Gardës së Republikës, të parashikuara nga ligji nr. 33/2021, si dhe me regjimin e posaçëm të godinës së Gjykatës, të klasifikuar si objekt “me rëndësi të veçantë”, përfshirë detyrimin për dorëzimin e pajisjeve elektronike sipas nenit 61, pika 9, të Rregullores së Gardës së Republikës, miratuar me VKM-në nr. 777/2021;
 - përputhet me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të administrimit të sigurisë gjyqësore, përfshirë standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në nenin 34 të Rregullores për procedurat gjyqësore, i cili parashikon ndalimin e mbajtjes së telefonit celular edhe për gjyqtarët, ndërsa lejon përdorimin e kompjuterit portativ për mbajtjen e shënimeve dhe ushtrimin efektiv të mbrojtjes;
 - gjen mbështetje në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, në çështjet Worm, Bédar, Pinto Coelho (nr. 2), Egeland dhe Hanseid dhe Leost, sipas së cilës mbrojtja e autoritetit të gjyqësorit, e privatësisë dhe e integritetit të procesit gjyqësor justifikon vendosjen e kufizimeve proporcionale;
 - nuk bie ndesh me Konventën CETS nr. 226 për Mbrojtjen e Profesioneve të Avokatit dhe as me nenet 339 deri 341 të KPP-së;
 - zbatohet në mënyrë të njëjtë ndaj të gjitha subjekteve procedurale, përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët, duke garantuar barazinë e armëve dhe neutralitetin institucional;

- vii. shoqërohet me garanci konkrete për ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, veçanërisht me lejimin e përdorimit të kompjuterit portativ dhe sigurimin e një ambienti të posaçëm për komunikimin konfidencial ndërmjet avokatit dhe klientit;
- viii. nuk cenon kompetencat procedurale të trupit gjykues dhe as regjimin ligjor të përgjegjësisë disiplinore të avokatëve.

69. Po kështu, GJKKO-ja sqaron se Rregullorja ka hyrë në fuqi më datë 01.09.2026 dhe se, si akt i miratuar sipas procedurës së parashikuar dhe në fuqi, ajo është e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin gjyqësor. Për rrjedhojë, GJKKO-ja kërkon nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë zbatimin e plotë të saj, përfshirë nenin 76. Në rast se Dhoma e Avokatisë vijon ta kontestojë këtë rregullim, ajo ka në dispozicion rrugët ligjore përkatëse për ta kundërshtuar atë përpara organeve kompetente; ndërkohë, kontestimi nuk e pezullon efektin juridik të Rregullores dhe nuk mund të shërbejë si shkak për mospjesëmarrje në seancat gjyqësore.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KANCELARI

SAIMIR SHYTI

